



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR EDUKIMIN DHE MJETET E INFORMIMIT PUBLIK

Tiranë, më 10.06.2019

(Komision për dhënie mendimi)

Dokument parlamentar

R A P O R T

për

PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995,
“KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 10.06.2019 mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, nismë e një grupi deputetësh të Partisë Socialiste.

Komisioni e shqyrtoi këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji komisioni caktoi relator z. Fadil Nasufi.

Për prezantimin e projektligjit përpara komisionit, si dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve mbi këtë projektligj, në cilësinë e nismëtarëve ishte i pranishëm z. Adnor Shameti.

I. Përputhshmëria me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit

Në aspektin kushtetues, projektligji është propozuar nga një grup deputetësh të Partisë Socialiste, në përputhje me nenet 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në aspektin procedural, projektligji shoqërohet me relacionin përkatës dhe në formën e kërkuar sipas përcaktimeve të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. Qëllimi dhe risitë që sjell projektligji

Ky projektligj sjell ndryshime në fusha të ndryshme, duke përfshirë parandalimin e veprimeve të dhunës në shoqëri, me anë të ashpërsimit të masave të dënimeve për veprat e dhunës ndaj policit, mjekut, sportistit, arbitrit, ndërmjetësit dhe trajnerit, funksionarëve publikë dhe të zgjedhurve, apo atyre që shërbejnë në shërbimin publik, si dhe përfshirja e veprave të reja penale për adresimin e duhur të çështjeve të dhunës si akte që ngarkojnë me përgjegjësi penale.

Ndryshimet e propozuara kanë të bëjnë edhe me çështjen e të drejtës së autorit, mbrojtja e së cilës mbetet një problem i vazhdueshëm, duke qenë se kjo e drejtë kërcënohet në formën e përdorimeve të padrejta të veprave të tjerëve, kopjimeve dhe formave të ndryshme të cenimit të kësaj të drejte. Pavarësisht se në Kodin tonë Penal ekzistojnë dispozita për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, vlerësohet se ato nuk janë të mjaftueshme dhe lënë hapësirë për abuzim me të drejtën e mbajtësve të tyre. Për këtë arsye nevojiten ndryshime për ashpërsimin e sanksioneve për këto vepra penale.

Një tjetër shqetesim për shoqërinë vijon të mbetet prishja e qetësisë publike kryesisht nga subjektet tregtare, të cilat nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit për zhurmat që shkaktojnë gjatë aktivitetit të tyre. Në këtë drejtim, në rastet kur konstatohet tejkalimi i normave të lejuara me ligj për zhurmat në mjedise që prishin qetësinë publike, propozohet ashpërsimi i dënimeve.

Ndryshime të tjera propozohen për veprat penale të cilat kanë të bëjnë me mbajtjen e armëve, armëve shpërthyes ose lëndëve plasëse në kundërshtim me parashikimet ligjore, apo pa leje të organeve kompetente, si dhe të veprimeve që synojnë pengesat apo ndalimin me çdo mjet e mënyrë të qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujqor e ajror. Ashpërsimi i sanksioneve për këto vepra penale ka si qëllim frenimin e përdorimit të armëve apo lëndëve plasëse, si dhe parandalimin e veprimeve që pengojnë qarkullimin e transportit në kundërshtim me parashikimet ligjore.

Një çështje tjetër mjaft e ndjeshme për shoqërinë, për të cilën propozohen ndryshime, është edhe ajo e sigurisë ushqimore.

Në projektligj propozohet krijimi i figurave të reja të veprave penale, si dhe rishikimi i dispozitave ekzistuese që lidhen me sigurinë ushqimore. Në këtë drejtim propozohen sanksione të ashpra për vepra të cilat aktualisht janë klasifikuar si kundravajtje administrative apo që nuk kanë asnjë parashikim të saktë ligjor. Për shkak të rëndësisë së

marrëdhënieve juridike që synojnë të mbrojnë, vlerësohet se ashpërsimi i sanksioneve për këto vepra duhet të rritet.

Mekanizmat ligjorë mbrojtës duhet të bëhen efektivë në mbrojtje të interesave të konsumatorëve, pasi cenimi i tyre paraqet një rrezik të lartë dhe ka impakt të drejtpërdrejtë për shëndetin dhe jetën e popullsisë në funksion të garantimit të sigurisë ushqimore.

Mbrojtja e mjedisit mbetet, gjithashtu, një problem shqetësues, për të cilën propozohen ndryshime në ashpërsimin e sanksioneve përkatëse. Projektligji përcakton dhe veprat penale të kryera nga persona fizikë a juridikë, me dashje apo nga pakujdesia, të cilat bien ndesh me legjislacionin specifik për mjedisin dhe për rrezatimet jonizuese apo me lejet/autorizimet që janë miratuar në zbatim të tyre dhe që rrezikojnë të shkaktojnë dëm real mbi cilësinë e ajrit, ujit, tokës, bimët, kafshët, shëndetin apo jetën e njeriut. Në këtë kuadër vlerësohet se legjislacioni ynë penal ka nevojë të plotësohet më tej, si dhe të rishikohen sanksionet përkatëse të parashikuara në Kodin Penal, për t'ju përgjigjur më mirë kërkesave të kohës në këtë fushë dhe harmonizimit të legjislacionit me atë të BE-së. Për të siguruar një vazhdimësi dhe konsistencë midis kërkesave ligjore të legjislacionit specifik/sectorial për mjedisin dhe rrezatimet jonizuese të përafuara tashmë me ato të BE-së me parashikimet e Kodit Penal, kërkohet që edhe ky i fundit të reflektojë kërkesat e legjislacionit European në fushën e mjedisit. Si pasojë e miratimit dhe zbatimit të këtyre amendimeve synohet dhe pritet që të rritet shumë ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit i të gjithë aktorëve që veprojnë mbi mjedisin dhe që kanë potencial për ta rrezikuar atë përmes aktiviteteve të tyre.

III. Vlerësimi i komisionit për dispozitat e projektligjit të cilat janë brenda fushës së veprimtarisë së tij.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik pas njohjes në tërësi me përmbajtjen e projektligjit nga prezantimi i nismëtarëve, duke qenë se dispozitat që lidhen me fushën e veprimtarisë së tij janë ato të përcaktuara në nenet 3 dhe 15 të projektligjit, të cilat kanë të bëjnë me *“Shkeljen e të drejtave të autorit”*, *“Goditjen e sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv”* dhe *“Veprime të dhunshme në aktivitetet sportive”*, kërkoi nga nismëtarët shpjegime të hollësishme për shkaqet që çuan në marrjen e nismës ligjore për propozimin e këtyre ndryshimeve dhe proporcionalitetit të sanksioneve të propozuara për këto vepra penale.

Relatori i projektligjit, shpjegoi ndryshimet e propozuara përmes këtij projektligji, duke theksuar se ndryshimet kanë ardhur si pasojë e problematikës së krijuar në këto dy fusha:

Së pari, në cenimin e të drejtës së autorit nga fenomeni i përhapur i përdorimeve të padrejta të veprave të tjerëve, kopjimeve dhe formave të ndryshme të cenimit të kësaj të drejte. Në këtë drejtim vlerësohet se ndryshimi ligjor i propozuar është i nevojshëm, pasi aktualisht dispozitat e Kodit Penal për këto vepra janë të pamjaftueshme.

Së dyti, pas disa ngjarjeve të ndodhura në disa aktivitete sportive, ku është ushtruar dhunë ndaj arbitrave apo trajnerëve dhe për parandalimin e tyre në të ardhmen, nevojiten ndryshime me karakter ashpërsues për cilindo që tenton të kryejë akte dhune ndaj sportistit,

trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv, për shkak të veprimtarisë sportive. Ndryshim i rëndësishëm është edhe parashikimi si vepër penale i hedhjes së sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve, mbajtja apo përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarrëve, flakadanëve gjatë zhvillimit të një aktiviteti sportiv.

Gjithashtu, penalizimi me ligj i hyrjes në fushën e lojës gjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit sportiv nga persona të paautorizuar ose pengimi i zhvillimit normal të aktivitetit sportiv, si dhe ashpërsimi më tej i sanksionit penal, kur këto vepra kryhen në aktivitetet sportive ndërkombëtare, janë të tjera masa shtrënguese të cilat do të ndikojnë në frenimin e akteve të tilla.

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, duke i vlerësuar të drejta dhe të nevojshme ndryshimet e propozuara në projektligj, në kuadër të përmirësimit të legjislacionit penal, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, vendosi miratimin e projektligjit në parim, nen për nen dhe në tërësi, duke bërë ndryshimet e mëposhtme:

Në nenin 3 të projektligjit bëhet ky ndryshim:

Në paragrafin e parë të nenit 149, c, pas togëfjalëshit “*mbajtësit e së drejtës*” shtohet “*në të gjitha format, mediumet dhe në internet*”.

Në nenin 3 të projektligjit bëhet ky ndryshim:

Neni 149/a “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, në pikën ç, togëfjalëshi “*me burgim deri në një vit*” bëhet “*me burgim deri në dy vjet*”.

Po në këtë nen, në paragrafin e fundit të tij, togëfjalëshi “*me burgim deri në dy vjet*” bëhet “*me burgim deri në tre vjet*”.

Ne nenin 5 te projektligjit behet ky ndryshim:

Ne nenin 201 të Kodit Penal, togëfjalëshi “*e ajrit dhe e tokës*” bëhet “*e ajrit, ujit dhe e tokës*”.

Në nenin 15 të projektligjit bëhen këto ndryshime:

Neni 274/a i Kodit Penal riformulohet si vijon:

“Goditja ose vepra të tjera dhune ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv, për shkak të veprimtarisë sportive, të kryera jashtë mjediseve sportive, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në mjediset sportive, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në mjediset sportive nga drejtues apo anëtarë të klubeve sportive, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.”

Në nenin "Neni 274/b" të Kodit Penal bëhet ky ndryshim:

Pas paragrafit të parë të këtij neni, shtohet paragrafi si vijon:

“Sjellja e dukshme antisportive apo e dhunshme që synon të nxisë alarm, panik dhe të përcjellë zemërim te pjesëmarrësit e tjerë, përbën veprë penale dhe dënohet me gjobë ose me punë në shërbim të komunitetit ose me 3 vjet burgim.

Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim dhe cenon zhvillimin normal të aktivitetit sportiv, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”.

Pas nenit 274/b, shtohet neni 274/c me këtë përmbajtje:

“Çdo sjellje e rezistencës së dhunshme ose frikësuese nga persona ndaj veprimtarive të personelit të sigurisë për mbajtjen e rendit publik, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë, me punë në shërbim të komunitetit ose me 2 vjet burgim.”

RELATOR

Fadil NASUFI

KRYETARE

Fatjona DHIMITRI